

Të Bërit Biznes në Europën Juglindore 2011: Përmbledhje

Ekziston një hamendësim në lidhje me faktin nëse ekonomitë e Europës Juglindore përbëjnë një rajon unik apo jo. Sigurisht, ky ka qenë një vend që historikisht është ndikuar nga politika dhe interesat e fuqive të huaja më tepër se sa nga forcat ekonomike. Megjithatë janë forcat ekonomike, veçanërisht ato që lidhen me tranzicionin dhe integrimin, dhe reformat e thella që nevojiten për të kaluar nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të tregut, të cilat e kanë imponuar vetveten si influencat më formuese në drejtim të politikave publike të rajonit. Ndërkohë që dikur ky rajon ishte frymëzim për termin 'ballkanizim' — i cili përshkruan shpërbërjen e një shteti në pjesë më të vogla antagonistë — e shkuara e afërt, pavarësisht nga kriza globale ekonomike, flet për një bashkëpunim në rritje, për zhvillim ekonomik dhe investime të huaja direkte. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, gradualisht rajoni është bërë një zone më e stabilizuar dhe më e zhvilluar ekonomikisht në periferinë më të afërt të Bashkimit Europian (BE).

Pavarësisht nga perceptimet, rajoni ka ecur përpara dhe ndryshimet që nga publikimi i raportit *Të Bërit Biznes në Europën Juglindore* në vitin 2008 e pasqyrojnë këtë fakt. Disa nga vendet kanë përparuar dhe më tej në tranzicion ndërsa të tjerë kanë ende rrugë për të bërë. Disa janë në prag të hyrjes në BE ndërsa të tjerë ende duhet të marrin statusin e vendit kandidat. Kroacia, e cila është në fazat përfundimtare të diskuti-

TABELA 1.1

Qytetet nga Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Moldavia, dhe Serbia mbajnë vendin e parë në 4 temat e matura të Të Bërit Biznes

		Klasifikimi (1-22)			
Ekonomia	Qyteti	Lehtësia e fillimit të biznesit	Lehtësia e trajtimit të lejes së ndërtimit	Lehtësia e regjistrimit të pronës	Lehtësia e zbatimit të kontratës
Shqipëria	Durrësi*	9	11	13	14
	Shkodra	8	3	9	11
	Tirana	10	NUK KA PRAKTIKË	16	18
	Vlora	7	9	10	10
Bosnja dhe Hercegovina	Banja Luka	18	3	21	15
	Mostari	20	13	22	20
	Sarajeva	19	9	19	19
Kosova	Prishtina	22	17	18	21
	Prizreni	21	6	14	22
Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë	Manastiri	2	12	3	5
	Shkupi	1	2	15	9
	Tetova*	3	3	6	3
Moldavia	Balti*	13	8	1	4
	Kishinaut*	17	19	1	2
Mali i Zi	Nikshiqi	5	1	6	17
	Pljevlja	4	6	4	7
	Podgorica	6	18	20	16
Serbia	Beogradi	11	21	16	11
	Krushevc	16	20	10	11
	Uzhice	12	16	10	6
	Vranja	14	13	5	7
	Zrenjanini	14	13	6	1

Shënim: Klasifikimi për secilën nga temat është bazuar në mesataren e thjeshtë të renditjes në përqindje për treguesit përbërës. Shiko shënimet e të dhënave për detaje të mëtejshme (këto mund të gjenden në raportin e kompletuar në gjuhën angleze).

*Qytet që nuk krahasohet tek raporti i 2008 për *Të Bërit Biznes në Europën Juglindore*.

Burimi: Baza e të dhënave e *Të Bërit Biznes*.


meve për hyrje në BE, nuk përfshihet më në raportin e këtij rajoni për vitin 2011. Nga ana tjetër, është shtuar Moldavia, një vend i reformuar së fundmi. Disa vende përballen me vështirësi të vazhdueshme politike të cilat mbeten sfida të hapura. Megjithatë, në përgjithësi, legjitimiteti politik që vjen nga progresi ekonomik ka qenë mësimi që qeveritë në të gjithë rajonin kanë marrë. Kjo është një shtysë e vazhdueshme për konkurrencë ndërmjet të gjithë këtyre vendeve. Ekonomitë konkurruese nuk mund të mbijetojnë si ishuj zhvillimi por duhet të ndërtojnë ndërvarësi me shtetet fqinjë dhe me vendet e tjera të rajonit. Si pasojë, forcat ekonomike po vendosin përparësinë e tyre në rajon. Aty ku më parë ka pasur dezintegrim politik, tregjet janë duke inkurajuar investime dhe lidhje tregtie përtej kufijve shtetëror.

Nuk ka një projekt të përkryer që garanton zhvillim dhe prosperitet, por një faktor i rëndësishëm është krijimi i klimës së investimeve që lehtëson fillimin dhe administrimin e një biznesi, ku ndjekja dhe respektimi i rregullave sjellin më shumë përfitime sesa kosto. Në një periudhë me buxhete të pamjaftueshme dhe përqindje të lartë papunësie, reformat të cilat do të lehtësonin zhvillimin e një biznesi marrin më shumë kuptim se asnjëherë tjetër. Ato ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen ekonomike pa kosto të lartë për qeveritë. Ky raport tregon që ekonomitë e Europës Juglindore kanë vazhduar të zbatojnë reformat mikro-ekonomike pavarësisht nga sfidat që vijnë nga kriza globale financiare. Raporti tregon gjithashtu që rezultatet e reformave të kohëve të fundit kanë dhënë frytet e tyre edhe në nivelin

FIGURA 1.1

Disa nga vendet* e rajonit kanë bërë hapa të mëdhenjë në drejtim të përmirësimit të rregulloreve tregtare

Progresi në renditjen globale të të bërit biznes: *Të Bërit Biznes* 2008 – 2011



* Të përfaqësuara nga kryeqytetet.
Burimi: Baza e të dhënave të *Të Bërit Biznes*.

lokal në të gjithë rajonin. Bashkangjitur faktorëve të tjerë — si për shembull disponueshmëria e një fuqie punëtore të aftë — përmirësimi i mjedisit të biznesit në qytetet dytësore të rajonit do të vazhdojë të ketë një ndikim pozitiv.

Të Bërit Biznes (Doing Business) e studion kuadrin rregullator të biznesit nga perspektiva e një firme vendase të vogël apo të mesme. Kryeqytetet përfaqësojnë ekonomitë e vendeve të Europës Juglindore në raportin global vjetor të *Të Bërit Biznes*, i cili krahason praktikatat rregullatore në 183 ekonomi në të gjithë botën. Por, brenda çdo ekonomie, sipërmarrësit përballen me rregulloret dhe praktikatat lokale të cilat ndryshojnë nga qyteti në qytet. *Të Bërit Biznes në Europën Juglindore 2008* ishte raporti i parë i cili shkonte përtej kryeqyteteve për 7 vende në rajon, për të parë këto ndryshime në 15 qytete të tjera nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia. Ky raport përditëson informacionet e paraqitura në 2008 për 6 vende (përveç Kroacisë) dhe përcjellë progresin e tyre në zbatimin e reformave të biznesit. Ai gjithashtu e shtrin analizën dhe në një vend tjetër (Moldavi) dhe 4 qytete të reja: Balti (Moldavi), Kishinaut (Moldavi), Durrës (Shqipëri), dhe Tetovë (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë). Rezultatet e këtyre 22 qyteteve si dhe krahasimi i ekonomive të 7 vendeve

për 4 tregues të *Të Bërit Biznes* jepen më lartë (tabela 1.1).

Në të gjithë rajonin është më e lehtë të fillohet një biznes në Shkup (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë), të nxjerrësh më lehtë një leje ndërtimi¹ në Nikshiq (Mali i Zi), të regjistrosësh pronën më me lehtësi në Balti dhe Kishinaut (Moldavi), dhe të realizosh më lehtë zbatimin e një kontrate në Zrenjanin (Serbi). Më e vështirë të fillosh një biznes është në Prishtinë (Kosovë), të regjistrosësh pronën në Mostar (Bosnje dhe Hercegovinë), dhe të zbatosh një kontratë në Prizren (Kosovë). Nxjerrja e lejeve të ndërtimit është më e vështirë në Beograd (Serbi), ndërsa në Tiranë (Shqipëri) nuk është lëshuar asnjë leje ndërtimi që nga viti 2009.

Në renditjen e qyteteve vërehen dy vëzhgime që ja vlen të diskutohen. Së pari, asnjë nga qytetet nuk ka performancë të shkëlqyeshme në të 4 fushat bashkë. Për shembull, Kishinaut (Moldavi) klasifikohet në majë ose afër kreut për lehtësinë me të cilën regjistrohen pronat dhe zbatohen kontratat, por mbetet prapa tek 2 treguesit e tjerë. Dhe ndërsa Shkupi (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) është në krye të performancës për sa i përket lehtësisë me të cilën mund të fillohet një biznes dhe për trajtimin e lejeve të ndërtimit, ky qytet mund të adoptojë praktika të mira nga Manastiri (Republika Ish-Jugosllave e

Maqedonisë) ose qytetet e Moldavisë për të përmirësuar performancën në lidhje me regjistrimin e pronave. Së dyti, ka një variacion të pasur në performancë sipas treguesve edhe ndërmjet qyteteve brenda të njëjtit vend – me përjashtim të fillimit të biznesit, ku të tre qytetet maqedonase mbajnë vendin e parë. Për shembull, në Mali të Zi, Podgorica dhe Pljevlja mund të ndjekin shembullin e Nikshiqit që të merren në mënyrë më efikase me lejet e ndërtimit. Për më tepër, Zrenjanini mund të japë një shembull pozitiv tek qytetet e tjera serbe në fushën e zbatimit të kontratave.

Gjatë krahasimit të performancës së qyteteve në 2011 me rezultatet nga viti 2008, vërehen disa tendenca. Së pari, performuesit e qëndrueshëm qëndrojnë në krye. Për shembull, Manastiri (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) e ka mbajtur pozicionin e vet ndër performuesit më të mirë në pjesën më të madhe të zonave të matura. Qytetet e tjera, si Krushevc (Serbi), kanë zbritje në krahasim me qytetet e tjera. Disa ndryshime në klasifikim mund t'i atribuohen shtimit të 4 qyteteve të reja, disa nga të cilat kanë kuadër konkurrues rregullator. Për shembull, Balti (Moldavi) renditet në krye për sa i përket lehtësisë me të cilën regjistrohen pronat. Tetova (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) është një nga qytetet më efçente për zbatimin e kontratave. Nga ana tjetër, qytetet që kanë përmirësuar më shumë rregulloret e tyre të biznesit në 3 vitet e fundit — si për shembull Shkupi (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) dhe Banja Luka (Bosnje dhe Hercegovinë) — i kanë tejkaluar disa nga qytetet e tjera.

EUROPA JUGLINDORE NËN NJË RITËM TË FORTË TË REFORMAVE

Shumë ndryshime kanë ndodhur në vitet e fundit. Rajoni ka qenë shumë aktiv në përmirësimin e rregulloreve të biznesit, shpesh në përgjigje të rrethanave — siç është aspirata për hyrjen në BE apo përballimi i krizës financiare globale. Disa nga ekonomitë e zonave të përfaqësuara me kryeqytetet e tyre përkatëse,

TABELA 1.2

Tani është më e lehtë të bësh biznes në të 19 qytetet e studiuar në 2008

Qyteti, Ekonomia	Fillimi i një Biznesi	Trajtimi i lejes së ndërtimit	Regjistrimi i pronës	Zbatimi i kontratës
Shkupi, Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë	✓	✓	✓	✓
Banja Luka, Bosnje dhe Hercegovinë	✓	✓	✓	✓
Vranja, Serbi	✓	✓	✓	x ✓
Nikshiqi, Mal i Zi	✓	✓		
Podgorica, Mal i Zi	✓	✓		
Uzhice, Serbi	✓	✓	✓	
Sarajeva, Bosnje dhe Hercegovinë	✓	✓	✓	
Manastiri, Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë	✓		✓	✓
Vlora, Shqipëri	✓		✓	✓
Mostari, Bosnje dhe Hercegovinë	✓	✓	✓	
Pljevlja, Mal i Zi	✓	✓		
Kishinaut, Moldavi	✓		✓	✓
Tirana, Shqipëri	✓		✓	✓
Beogradi, Serbi	✓	x	✓	
Shkodra, Shqipëri	✓			✓
Zrenjanini, Serbi	✓		✓	
Prizreni, Kosovë	x ✓			
Prishtina, Kosovë	x ✓			
Krushevc, Serbi	✓			x

✓ Reforma të Të Bërit Biznes të cilat e lehtësojnë procesin e të bërit biznes

x Reforma të Të Bërit Biznes të cilat e vështirësojnë procesin e të bërit biznes

Shënim: Të 19 qytetet e studiuar në 2008 si dhe në 2011 renditen sipas numrit dhe ndikimit të reformave të ndërmarrja. Në majë të klasifikimit janë qytetet ku shumica e reformave që lehtësojnë më shumë të bërit biznes u zbatuan ndërmjet Janarit 2008 dhe Janarit 2011 dhe të cilat kanë arritur rritjet më të mëdha në renditjen e tyre në lidhje me 4 temat e Të Bërit Biznes që janë matur që në 2008.

Burimi: Baza e të dhënave të Të Bërit Biznes.

janë njohur si 10 reformuesit kryesues të raportit Të Bësh Biznes në nivel global, gjatë 5 viteve të fundit: Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë në 2006/2007, Shqipëria në 2007/2008, dhe (sërisht) Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë si dhe Moldavia në 2008/2009. Siç vihet re (figura 1.1), Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë ka zbatuar 17 reforma të raportit të Të Bërit Biznes në 2011. Në raportin më të fundit të Të Bërit Biznes të vitit 2011, Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë renditet e 38-ta nga 183 ekonomitë — një përmirësim me 37 pozicione në 5 vite.

Raporti i 2008 i Të Bërit Biznes në Europën Juglindore identifikoi praktikat e mira, vuri në dukje vështirësitë dhe dha rekomandimet për reformat e biznesit përtej kryeqyteteve të rajonit. Tre vjet më vonë, ky raport monitoron progresin e bërë gjatë kësaj kohe. Rezultatet janë mbresëlënëse. Të gjitha 19 qytetet e matura për herë të dytë tregojnë përmirësime në të paktën 1 nga 4 treguesit

e matur (tabela 1.2). Shumica e qyteteve përfituan nga realizimi për herë të parë i reformave të biznesit në nivel qendror, të cilat janë përmbledhur më poshtë — megjithëse rezultatet e zbatimit nga qyteti në qytet ndryshojnë.

Brenda rajonit, 2 qytete veçohen: Shkupi (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) dhe Banja Luka (Bosnje dhe Hercegovinë) janë përmirësuar më shumë që nga viti 2008. Reformat e biznesit u zbatuan në të katër treguesit e matur, duke rezultuar në përfitime të konsiderueshme përsa i përket kohës dhe kursimit të kostove për sipërmarrësit.

“One Stop Shop” në Shkup (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) e uli kohën për fillimin e një biznesi nga 12 ditë në 2008 në vetëm 3 ditë tani duke eliminuar 5 procedura. Kjo u ofron sipërmarrësve një seri shërbimesh — duke përfshirë regjistrimin e një biznesi të ri tek autoritetet e taksave dhe ato statistikore, sigurimin e një liçence treg-

tie, publikimin e një njoftimi për një ndërmarrje, dhe regjistrimin e punonjësve për sigurimin shëndetësor dhe të pensionit.² Ndërkohë, Ligji i ri i Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë “për ndërtimet” e zhvendosi përgjegjësinë për mbikqyrjen e ndërtimeve dhe kontrollin nga agjencitë publike të zbatimit tek profesionistët e liçencuar. Si rezultat, koha që nevojitet për të marrë lejet e ndërtimit në Shkup ra me më shumë se 2 muaj ndërkohë që 6 procedura u eliminuan. Për më tepër, pas shtimit të stafit të kadastrës në Shkup, koha që nevojitej për regjistrimin e pronave ra me më shumë se 1 muaj — nga 98 ditë në 2008 në vetëm 58 ditë në 2011. Në fund, gjykata e çështjeve tregtare në Shkup e pajisur me një sistem elektronik të menaxhimit të rasteve, u vu në funksionim në 2008, duke lehtësuar zbatimin e kontratës në çështjet tregtare.

Në Banja Lukë (Bosnje dhe Hercegovinë), leja e shfrytëzimit nuk nevojitet më për të gjitha bizneset dhe regjistrimin e biznesit e mori përsipër një gjykatë e specializuar për çështjet tregtare në 2010. Si rezultat, koha për fillimin e biznesit ra me më shumë se 1 muaj. Ndërsa, Ligji i Republikës Serbe të Bosnje dhe Hercegovinës në 2010 “për Ndërtimet dhe Planifikimin Urban” i dha mundësinë kompanive private të përgatisin vet disa dokumente për ndërtimet, duke e bërë më efikas procesin e marrjes së lejes për planifikimin urban. Për më tepër, më shumë se 80% e kadastrës dhe 90% e regjistrave të regjistrimit të tokës janë tashmë të vlefshme në formë dixhitale. Si rezultat, koha totale që nevojitet për trajtimin e lejeve të ndërtimit ra nga 1 vit në 2008 në 8 muaj sot. Në të njëjtën kohë, koha për të regjistruar pronat ra me 3 muaj pasi 4 procedura — duke përfshirë kërkesën për autorizimin për të firmosur, heqjen e taksave dhe vlerësimin në terren të pronës — u eliminuan. Në fund, Ligji “për ndryshime në Ligjin për Gjykatat”, që hyri në fuqi në Maj 2010, i dha juridiksionin një gjykatë të specializuar për çështjet tregtare në Banja Luka, duke e shkurtuar kohën që nevojitej për ankimin e një çështjeje në gjykatë nga

6 muaj në 2008, në 46 ditë në 2011. Në të njëjtën kohë, koha për përmbartimin e vendimeve gjyqësore ra me më shumë se 200 ditë.

Të tëra, 19 qytetet e matura për herë të dytë në vitin 2011 e kanë lehtësuar fillimin e një biznesi. Reforma më e njohur për fillimin e biznesit që në 2008 ishte krijimi ose përmirësimi i "One Stop Shop"-ve — siç u pa në 10 qytete. Për shembull, në Beograd (Serbi), regjistrimi me agjenci të ndryshme është konsoliduar në të njëjtën ndërtesë. Sigurimi i një certifikate për regjistrimin e biznesit, numri i identifikimit të taksave, certifikata për fondin e pensionit dhe certifikata për fondin e shëndetit mund të merren të gjitha me një shkuarje të vetme tek Agjencia e Regjistrimit të Biznesit (SBRA). Ndërkohë, qytetet e tjera serbe që janë studiuar nga ky raport janë ende duke punuar për zbatimin e plotë të "One Stop Shop"-ve të tyre — në mënyrë të veçantë fondi i pensionit dhe regjistrimet e fondit të shëndetit duhet që ende të bëhen veç e veç. Megjithatë, koha për të filluar një biznes në të gjitha qytetet serbe ka rënë në mënyrë të konsiderueshme — më se shumti në Zrenjanin, ku koha u shkurtua nga 37 ditë në 2008 në 17 ditë në 2011. Në Kishinaut dhe Balti (Moldavi), unifikimi i regjistrimit të biznesit me procedurat e tjera është ende në proces. Pavarësisht nga kjo, hapa pozitive janë bërë për të reduktuar të gjithë kohën e fillimit të biznesit — duke përfshirë vendosjen me urdhër të afateve kohorë të detyrueshëm për t'u zbatuar dhe mundësi më të shpejta për regjistrimin e biznesit. Si rezultat, koha që duhet për të nxjerrë një certifikatë regjistrimi u reduktua nga 15 ditë në 2008 në vetëm 1 ditë tani. Disa reforma të tjera të njohura për fillimin e biznesit ishin reduktimi i kërkesave dhe tarifave lokale të licencimit. Për shembull, në qytetet shqiptare u eliminua kërkesa për t'u regjistruar në Dhomat lokale të Tregtisë. Qytetet në Mal të Zi eliminuan licencën bashkiake të biznesit. Prishtina dhe Prizreni në Kosovë i shkurtuan përgjysëm tarifat bashkiake të lejeve të biznesit — respektivisht nga EUR 1,000 në EUR 525 dhe

në EUR 400.

Në fushën e lejeve të ndërtimit, 9 nga 19 qytetet e matura në 2008 dhe 2011 kanë përfutur nga reformat siç janë dixhitalizimi i regjistrave të kadastrës, vendosja në funksionim e ligjeve të reja për ndërtimin dhe inspektimet e përmirësuar. Për shembull, Mali i Zi prezantoi miratimet e lejeve të ndërtimit me bazë riskun, ku projektet me rrezik të ulët dhe të shkallës së vogël, rishikohen dhe miratohen nga bashkitë dhe jo nga qeveria qendrore. Në Serbi, Ligji i vitit 2009 "për Planifikimin dhe Ndërtimet" thjeshtoi procedurat për trajtimin e lejeve të ndërtimit dhe i bëri të transferueshme ato ndërmjet investitorëve gjatë ndërtimit. Ndikimi i ligjit të ri ndryshon nga qyteti në qytet. Në Vranje, tani leja e ndërtimit mund të merret për 6 muaj — 3 muaj më shpejt se në 2008. Nga ana tjetër, në Beograd, i njëjti proces kërkon gati një vit — 5 muaj më shumë se në 2008. Sfidë më e madhe në zbatimin e këtij ligji është aplikimi i dispozitave në lidhje me kthimin e 'të drejtave të përdorimit' në të drejta pronësie. Nga ana tjetër, në Shqipëri, Parlamenti miratoi Ligjin për Planifikimin Territorial në 2009. Me t'u vënë në zbatim (pritur hyrja në fuqi në shtator 2011), ky ligj i ri pritet të profesionalizojë strukturën e Këshillit të Rregullimit të Territorit (KRT) — autoriteti i ngarkuar për dhënien e lejeve të ndërtimit në Tiranë. Që nga viti 2009, në Tiranë nuk është nxjerrë asnjë leje ndërtimi, kryesisht sepse partitë politike rivale që janë të përfaqësuara në KRT e kanë të pamundur të arrijnë vendime me konsensus. Ligji i ri për Autorizimin e Ekzekutimit të Ndërtimeve, miratuar nga parlamenti Moldav në Korrik 2010, vendosi me statut kufij kohorë për aprovimin e projektit dhe konsolidoi zbardhjen e projektit. Procesi i mëpasshëm i zbatimit pritet t'i bëjë më eficientë procedurat e trajtimit të lejeve të ndërtimit.

Reformat në regjistrimin e pronës rezultuan në kursimin e kohës dhe kostove për sipërmarrësit në 12 nga 19 qytetet e matura në 2008 dhe 2011. Qeveritë në të gjithë rajonin po dixhitalizojnë regjistrat e tokës dhe po i bëjnë ato

më eficientë nëpërmjet reformave legjislative dhe administrative. Si rezultat, koha mesatare për të regjistruar pronat në të gjitha qytetet në Europën Juglindore ra me më shumë se një muaj që nga 2008. Për shembull, në Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë), ku të gjithë regjistrat e tokës dhe librat e kadastrës tashmë janë të disponueshme në formë dixhitale, koha që nevojitet për regjistrimin e pronave është vetëm një e dhjeta e asaj që ishte më parë. Në mënyrë specifike, ra nga 331 ditë në 2008 në vetëm 33 ditë në 2011. Në Mostar (Bosnje dhe Hercegovinë), ku 95% e regjistrave të kadastrës tashmë janë në formë të dixhitalizuar, koha e regjistrimit të pronave ra me një muaj — nga 145 ditë në 2008 në 117 ditë në 2011. Ndërkohë, Moldavia dhe Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë janë në proces të dixhitalizimit të respektivisht, regjistrave të tokës dhe hartave të kadastrës. Përpjekjet e tjera të reformave të biznesit të ndërmarrja nga qeveritë në tre vitet e fundit përfshijnë prezantimin e kufijve kohorë të detyrueshëm për t'u zbatuar, eliminimin e certifikatave dhe zbardhjet para shitjes e uljen e tarifave. Për shembull, në Moldavi sipërmarrësit nuk kanë më nevojë të dorëzojnë një skicë kadastrale për pronat e regjistruara në kadastrë — duke e ulur kohën totale të regjistrimit të pronave nga 48 ditë në 2008 në 5 ditë në 2011. Në Shqipëri, një kufi kohor i detyrueshëm, i zbatuar së fundmi, shkurttoi vonesat në regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me 9 ditë në Tiranë dhe 12 ditë në Vlorë. Në Republikën Ish-Jugosllave të Maqedonisë, informacioni mbi çështjet e tokës u transferua nga gjykatat e shkallës së parë në kadastrë, kështu që tani si certifikata e pronësisë ashtu dhe certifikata që prona nuk ka barrë mund të merren nga i njëjti institucion. Po ashtu, përpjekje të ngjashme janë duke u bërë në Serbi. Bashkë me dixhitalizimin e hartave të kadastrës, këto përpjekje për reforma e kanë shkurtuar kohën e regjistrimit të pronave me 30 ditë në Zrenjanin, 25 ditë në Vranje, 20 ditë në Beograd dhe 17 ditë në Uzhice.

Zbatimi i një kontrate u bë më

i shpejtë, më i lirë dhe/ose më pak i vështirë në 8 nga 19 qytetet e studiuar si në 2008 ashtu dhe në 2011. Gjykatat në këto qytete kanë zbatuar reforma administrative ose ligjore për të reduktuar kohën ose koston e zgjidhjes së çështjeve tregtare. Në Vranje (Serbi), të dhënat gjyqësore dhe dosjet e mbajtura me dorë u zëvendësuan me dosje elektronike të cilat janë të përdorshme online. Për më tepër, një sistem i kompjuterizuar i cakton gjyqtarëve në mënyrë të rastësishme çështjet gjyqësore, duke eliminuar mundësitë për neglizhime apo korrupsion. Si rezultat, periudha e gjykimit në Vranje ra nga 495 ditë në 2008 në 135 ditë në 2011. Në Shqipëri, një dekret presidencial shtoi gjyqtarët në gjykata. Duke pasur më shumë staf në punë, koha e gjykimit ra me 40 ose më shumë ditë në Shkodër dhe Vlorë. Tani gjykatat këtu nxjerrin vendime në më pak se 4 muaj. Nga ana tjetër, tarifatat e përmbartimit u reduktuan nga 7% të vlerës së deklaruar në 2% në mbarë Shqipërinë. Ndërkohë, Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë lehtësoi zbatimin e kontratave duke vendosur kufij kohorë për pagesën e tarifave gjyqësore, duke rregulluar nivelin monetar për caktimin e juridiksionit të çështjeve, dhe duke prezantuar një gjykatë për pa-ditë me shuma më të vogla.

KRAHASIMI I RREGULLOREVE TË BIZNESIT NË 22 QYTETE NË EUROPËN JUGLINDORE

FILLIMI I NJË BIZNESI

Shkupi (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) është performuesi i 5-të në krye të listës botërore në këtë fushë. Ajo çfarë duhet të bëjë një sipërmarrës për të filluar një biznes këtu është të shpenzojë 3 ditë dhe pak më shumë se 100 dollarë amerikanë. Në qytetet si Shkupi, ku janë ndërtuar “One Stop Shop”-e dhe janë plotësisht funksional, fillimi i një biznesi mund të bëhet shpejt dhe në mënyrë efikase. Megjithatë, procesi është shumë i ngadaltë në qytetet ku sipërmarrësi duhet të regjistrohet veçmas për taksat, kontributet sociale, sigurimin shëndetësor dhe lejet bashkiake. Kjo është situata

në Prishtinë (Kosovë), ku duhen pothuajse 2 muaj për të filluar një biznes. Në Mostar (Bosnje dhe Hercegovinë), ku gjykatat janë të ngarkuara për të bërë regjistrimin e bizneseve dhe ku janë të nevojshme 8 kërkesa pas regjistrimit të biznesit, mund të nevojiten 50 ditë për fillimin e një biznesi. Diferencat e kostove brenda rajonit janë gjithashtu domethënëse. Kostoja për të hapur një biznes varion nga 1,5% e të ardhurave për frymë në Nikshiq dhe Pljevlje (Mal i Zi) — ngjashëm me Finlandën — në 31,4% në Tiranë (Shqipëri) — që është 5 herë më shumë se mesatarja e BE-së. Ndryshimet vijnë nga tarifatat e ndryshme që mbledhen në nivel lokal. Disa qytete, si për shembull Prishtina dhe Prizreni (Kosovë), kanë respektivisht tarifatat 525 dhe 400 Euro, vetëm për lejen bashkiake. Në 12 nga 22 qytetet e matura, sipërmarrësve u kërkohet gjithashtu të vendosin mënjandë një sasi minimale të kapitalit para se të fillojnë punën. Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë është ekonomia e vetme e cila e ka hequr kërkesën për kapital minimal, ndërsa Shqipëria dhe Mali i Zi kanë vetëm shuma nominale (baraz me 1 dollarë amerikanë).

TRAJTIMI I LEJES SË NDËRTIMIT

Nxjerrja e lejeve të ndërtimit mund të jetë e vështirë dhe e shtrenjtë në Europën Juglindore. Mesatarisht, një kompani ndërtimi do t'i duhet të shpenzojë 223 ditë dhe më shumë se 1.100% të të ardhurave për frymë për të përmbushur të gjitha kërkesat për të ndërtuar një magazinë. Krahasojeni këtë me BE-në, ku një kompani ndërtimi shpenzon mesatarisht një muaj më pak dhe vetëm 77% të të ardhurave për frymë. Ndërkohë që në Europën Juglindore i gjithë autoriteti për krijimin e politikave i takon qeverive qendrore, zbatimin e rregulloreve në nivel lokal ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Qeveritë vendore kanë autoritetin për të administruar disa procedura dhe për të mbledhur taksat dhe tarifatat përkatëse. Numri i procedurave për trajtimin e lejeve të ndërtimit varion nga 15 në Shkup (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) dhe Pljevlje

(Mal i Zi) në 30 në Kishinaut (Moldavi). Në Kishinaut, një sipërmarrës duhet të plotësojë jo më pak se 18 kërkesa para fillimit të një ndërtimi — si për shembull miratimi i vendit dhe vlerësimet teknike. Ashtu siç rezultoi edhe në raportin e vitit 2008, trajtimi i lejeve të ndërtimit është prapë më i shpejtë në Manastir (Republika Ish-jugosllave e Maqedonisë) — vetëm 3 muaj. Kjo është më e ngadaltë në Mostar (Bosnje dhe Hercegovinë) — një vit e gjysëm. Kostoja varion nga 110% e të ardhurave për frymë (1.752 dollarë amerikanë) në Balti (Moldavi) në një vlerë shumë të lartë prej 2.132% të të ardhurave për frymë (139.650 dollarë amerikanë) në Podgoricë (Mal i Zi). Në shumicën e vendeve, pjesa më e madhe e shpenzimeve shkon për tarifatat dhe koston që lidhet me vetë lejen e ndërtimit. Në qytetet serbe, marrja e një lejeje ndërtimi përbën, mesatarisht, 76% të të gjithë koston (baraz me 83.278 dollarë amerikanë). E njëjta leje kushton shumë më pak në Balti (Moldavi), ku përbën 28% të të gjithë koston (baraz me 439 dollarë amerikanë). Në Podgoricë (Mal i Zi), investitorët duhet të paguajnë një tarifë urbane të zhvillimit, e cila përbën pothuajse tre të katërtat e të gjithë koston (baraz me 100.221 dollarë amerikanë).

REGJISTRIMI I PRONËS

Në të 22 qytetet, një sipërmarrës duhet të kalojë mesatarisht në 6 procedura, duhet të presi 48 ditë, dhe të paguajë 2,85% të vlerës së pronës për të transferuar një hipotekë/certifikatë pronësie. Brenda rajonit, koha, kostoja dhe kërkesat ndryshojnë në mënyrë domethënëse. Regjistrimi i pronave është më i lehtë në Balti dhe Kishinaut (Moldavi), ku nevojiten 5 procedura, 5 ditë dhe 0,9% e vlerës së pronës për të transferuar një titull pronësie. Në kontrast me këtë, i njëjti proces kërkon 8 procedura në Prishtinë (Kosovë) dhe pothuaj 4 muaj në Mostar (Bosnje dhe Hercegovinë). Kryesisht ndryshimet shfaqen në fazën e para-regjistrimit. Për shembull, në Mostar dhe Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë), të dyja palët, kompania shitëse dhe ajo blerëse, duhet të kenë një ven-

TABELA 1.3

Praktikat më të mira në Europën Juglindore, krahasuar në rang ndërkombëtar

	Qyteti me performancë më të mirë në Europën Juglindore	Performanca	Renditja Globale (183 ekonomi) Si do të ishin qytetet e Europës Juglindore në rang global
Ditët për të filluar një biznes	Shkupi (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë)	3 ditë	3
Numri i proçedurave për të filluar një biznes	Shkupi (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë)	3 proçedura	8
Ditët për të regjistruar një pronë	Balti dhe Kishinaut (Moldavi)	5 ditë	10
Ditët për të zbatuar një kontratë	Tetova (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë)	290 ditë	18
Kostoja për të filluar një biznes	Nikshiqi, Pljevlja (Mal i Zi)	1,5% e të ardhurave për frymë	18
Kostoja për të regjistruar një pronë	Prizreni (Kosovë)	0,5% e vlerës së pronës	19
Ditët për trajtimin e një leje ndërtimi	Manastiri (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë)	96 ditë	27
Kostoja për të përmbaruar një kontratë	Kishinaut (Moldavi)	20,9% e vlerës së deklaruar	48
Numri i proçedurave për të regjistruar një pronë	Balti dhe Kishinaut (Moldavi) Manastiri, Shkupi, dhe Tetova (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë)	5 proçedura	50
Numri i proçedurave për trajtimin e një leje ndërtimi	Shkupi (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) Pljevlja (Mal i Zi)	15 proçedura	67
Kostoja për trajtimin e një leje ndërtimi	Balti (Moldavi)	110,2% e të ardhurave për frymë	74
Praktikat më të mira për 4 treguesit e matur			6
Qyteti hipotetik në Europën Juglindore			

Burimi: Baza e të dhënave të Të Bërit Biznes

dim gjyqësor me shkrim i cili autorizon firmosësin e marrëveshjes të veprorë në emër të kompanisë. Në Prishtinë (Kosovë), përveç hipotekës/certifikatës së pronësisë, palët duhet të sigurojnë dhe dorëzojnë kopje të certifikuar të regjistrimeve të bizneseve të kompanive të tyre dhe letrat nga autoritetet e taksave ku vërtetohet se janë paguar të gjitha taksat për pronën para se avokati të hartojë marrëveshjen e shitjes dhe blerjes së pronës. Ndryshimet në kohë ndërmjet qyteteve burojnë kryesisht nga efikasiteti i regjistrimit të pronës tek regjistrimi i pronarëve të rinj të pronës. Kjo varion nga 1 ditë në qytetet Moldave, nëse ato përdorin opsionin më të shpejtë, në 85 ditë në Beograd (Serbi). Sasia e taksave për transferimin e pronës që sipërmarrësit duhet të paguajnë varion shumë ndërmjet 22 qyteteve të studiuara — nga një tarifë fikse prej EUR 150 (220 dollarë amerikanë) në Prishtinë (Kosovë) në 5% të vlerës së pronës në Mostar dhe Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë).

ZBATIMI I KONTRATËS

Gjykata më efiçente që zgjidh çështjet tregtare në rajon është në Zrenjanin (Serbi). Pas vetëm 10 muajsh nga ankimi tek përmbarimi, proçesi është

po aq i shpejtë sa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në Zrenjanin, informatika përdoret për t'i ardhur në ndihmë gjykatësve me regjistrimin e rasteve dhe menaxhimin e gjykatës. Sipërmarrësit gjithashtu mund të zgjedhin të kalojnë në një sistem alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjes (ADR), i cili ka ulur numrin e çështjeve në pritje në gjykatat tregtare në të gjithë Serbinë. Ndërkohë, në Mostar (Bosnje dhe Hercegovinë), një sipërmarrës duhet të presi më shumë se 4 vjet për ta vënë në zbatim një kontratë nëpërmjet gjykatës — situatë e ngjashme me Kabul (Afganistan), një nga gjykatat më të ngadalta në botë. Vonesat vijnë si shkak i ngarkesës së çështjes dhe një numri të pamjaftueshëm të gjykatësve. Përsa i përket shpenzimeve, proçesi mesatar gjyqësor në Europën Juglindore kushton 32% të vlerës së padisë —një e treta më e shtrenjtë sesa mesatarja e BE-së. Në të gjithë rajonin, pjesa më e madhe e kostove të proçesit gjyqësor rregullohen me ligj dhe programime tarifash. Kostoja e zbatimit të një kontrate varion nga 21% e vlerës së padisë në Kishinaut (Moldavi) — në mënyrë të ngjashme me Australinë — në 61% në Prishtinë dhe Prizren (Kosovë).

TË MËSOJME NGA NJËRI-TJETRI

Ndërsa një dekadë më parë bashkëpunimi dhe ndarja me njëri tjetrin e eksperiencave të reformave nuk ka qenë një prioritet për ekonomitë e rajonit, tani kjo është kthyer në normë. Pa dyshim, shtytësi kryesor ka qenë hyrja në BE. Kjo vazhdon ende të jetë e vërtetë, realitetet e tregjeve gjithmonë e në rritje po e sjellin bashkëpunimin në nivele të reja. Për shembull, gjatë grumbullimit të të dhënave për këtë studim në fund të vitit 2010, kompanitë hekurudhore të Kroacisë, Sllovenisë dhe Serbisë formuan një kompani të re me aksione të përbashkëta për t'i shërbyer rrugës së ngarkesave të Korridorit 10 European për në Stamboll, i cili pas hapjes së tunelit të Bosforit do të lidhë Europën me Azinë, e deri në Kinë. Mundësitë për të forcuar pozicionin e ekonomive kombëtare nëpërmjet konkurrencës së përmirësuar rajonale ekzistojnë dhe në sektorët e tjerë. Ky lloj bashkëpunimi ekonomik mund të mos tërheqë të njëjtin nivel të interesit të medias ashtu si ngjarjet e 90-ave por tregon për një të ardhme më të pasur e më të qëndrueshme në Europën Juglindore. Përmirësimi i vazhdueshëm i mjedisit të biznesit është thelbësor për këtë synim.

Ushtrimet studimore apo analizuese si *Të Bërit Biznes* frymëzojnë qeveritë të reformojnë rregulloret e tyre tregtare. Ato tregojnë sfidat e mundshme dhe identifikojnë vendet ku politikë-bërësit mund të gjejnë praktikatat më të mira. Krahasimet ndërmjet qyteteve, brenda një vendi të vetëm ose rajoni, janë shtytës edhe më të fortë, pasi qeveritë e kanë të vështirë të shpjegojnë pse të bësh biznes në disa nga qytetet e tyre mund të jetë më e vështirë sesa në qytetet e tjera fqinje. Lajmi i mirë është se të pasurit e një kuadri ligjor të ngjashëm lehtëson zbatimin e praktikave të mira brenda një rajoni. Qeveritë kombëtare mund të përdorin gjithashtu të dhënat e *Të Bërit Biznes* për të monitoruar se si ndryshimet në rregulloret kombëtare zbatohen nga autoritetet lokale. Në një botë ku vendet konkurrojnë me njëri tjetrin për të tërhequr investimet, të dhënat në nivel lokal u lejojnë qeverive lokale të rishikojnë kushtet me të cilat përballen sipërmarrësit në qytetet e tyre nga një këndvështrim krahasues. Të dhënat në nivel lokal janë tashmë të disponueshme për më shumë se 300 qytete në 38 vende në të gjithë botën.

Qeveritë të cilat janë të vendosura për të reformuar mund të përdorin treguesit e *Të Bërit Biznes* për të motivuar dhe mbështetur përpjekjet për reformat e biznesit. Nuk është e domosdoshme të shpiken metoda të reja: mjafton të fillohet duke prezantuar reformat e biznesit të cilat kanë qenë të suksesshme në vende të tjera. Në fakt, qytetet në Europën Juglindore kanë shumë për të përfituar nga adoptimi i rregulloreve dhe praktikave më të mira të cilat funksionojnë mire në vendet e tjera të rajonit. Një qytet hipotetik ku do të adoptoheshin të gjitha praktikatat më të mira të identifikuar në këtë raport do të renditej i 6-i ndër 183 vendet në rang global — ngjashëm me Danimarkën ose Kanadanë (tabela 1.3). Nëse do të ishin adoptuar praktikatat më të mira të rajonit, fillimi i një biznesi do të kërkonte vetëm 3 ditë, si në Shkup (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) dhe Suedi. Sipas praktikave më të mira të rajonit transferimi i hipotekës/certifi-

katës së pronësisë do të kërkonte vetëm 5 procedura në 5 ditë, si në Moldavi apo Australi. Ndërkohë, praktikatat më të mira të rajonit për të trajtimin e lejeve të ndërtimit do të kërkonin vetëm 96 ditë — siç shihet në Manastir (Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë) apo në Mbretërinë e Bashkuar. Në fund, zgjidhja e një mosmarrëveshjeje tregtare në qytetin hipotetik me praktikatat më të mira në Europën Juglindore do të kishte të njëjtën kosto si mesatarja e BE-së, ndërsa kohëzgjatja do të ishte 100 ditë më shpejt se në Gjermani. Rezultatet nga reformat e biznesit mund të jenë të mëdha. Kursimi i kohës dhe parave shpesh janë përfitimet më imediate që kanë firmat. Për shembull, në Gjeorgji, një sondazh i vitit 2009 zbuloi se qendra e tyre e shërbimit për fillimin e biznesit i ndihmonte bizneset të kursenin një mesatare prej 3,25% të fitimit—dhe kjo vetëm për shërbimin e regjistrimit. Për të gjitha bizneset e shërbyera, kursimet direkte dhe indirekte shkonin në 7,2 milion dollarë amerikanë.³ Në Meksikë; “One Stop Shop”-et lokale (SARE) e shkurtuan kohën e të bërit biznes nga 58 në 13 ditë. Një studim i kohëve të fundit pasqyron përfitimet ekonomike nga një reformë e tillë: numri i firmave të reja meksikane të regjistruara u rrit me 5%, punësimi u rrit me 2,8%, dhe çmimet ranë me nga afërsisht 1% për shkak të konkurrencës nga bizneset e reja që u krijuan.⁴

Reformuesit e qëndrueshëm ndjekin një axhendë afatgjatë dhe vazhdojnë të ecin përpara. Vendi i renditur në krye të listës përse i përket lehtësisë së të bërit biznes, Singapori, ndërmerr reforma biznesi çdo vit. Reformat me shtrirje të gjërë për biznesin që përfshijnë disa tregues të *Të Bërit Biznes*, japin rezultate më të mira. Bashkëpunimi në pjesë të ndryshme të burokracisë, në nivelin lokal dhe kombëtar, është i nevojshëm për reforma të tilla. Vullneti dhe vizioni politik që vijnë nga një kampion reformash — qoftë ky një kryeministër, ministër apo kryebashkiak — është thelbësor për të patur sukses. Për më tepër, reformuesit e qëndrueshëm janë gjithëpërfshirës — i kanë të gjithë aktorët përkatës dhe i

institucionalizojnë përpjekjet e tyre për reforma. Ata gjithashtu qëndrojnë të fokusuar në qëllime specifike dhe monitorojnë rregullisht progresin.

1. Treguesi mbi trajtimin e lejes së ndërtimit përfshin të gjitha procedurat të cilat një kompani duhet ti kalojë nga momenti kur vendosë të ndërtojë një godinë deri në momentin kur e regjistron godinën e sapondërtuar tek zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Mes të tjerash, ketu përfshihen miratimet nga agjencitë përkatëse para se të merret leja e ndërtimit, nxjerrja e lejes së ndërtimit, lidhja me shërbimin e ujësjellës-kanalizimit, elektrikut, dhe telefonisë fikse, pajisja me lejen e shfrytëzimit, si dhe regjistrimi në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
2. Projekti i “One Stop Shop” në Republikën Ish-Jugosllave të Maqedonisë po kalon në një fazë të dytë e cila synon të unifikojë regjistrimin e biznesit dhe regjistrimin e punonjësve për kontributet sociale. Faza e dytë është duke u zbatuar nëpërmjet një projekti pilot në Shkup dhe pritet të mbulojë të gjithë vendin deri në fund të 2011.
3. Banka Botërore 2010. *Të Bërit Biznes 2011: Bërja e diferencës për Sipërmarrësit*. Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore.
4. Bruhn, Miriam. 2008. “Liçenca për Shitje: Efekti i Reformës së Regjistrimit të Biznesit për Aktivitetin Sipërmarrës në Meksikë.” Raporti i punës për studimin e politikave 4538. Uashington, D.C.: Banka Botërore.